

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, Jonuz Bugari, kryetar i trupit gjykues, gjyqtarëve porot: Aliriza Sokoli dhe Selami Gashi, antarë të trupit gjykues, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të paditësit S. K. nga fshati P., Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati M. B. nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës O. M. nga fshati D., Komuna e Rahovecit, për shkak të besimit të fëmijës jashtëmartesor në përkujdesje, ruajtje dhe edukim, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor dhe zbatimit të provave, më 18.07.2018 morri këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit **S. K.**, në mënyrën si vijon:

FËMIJA F. K. i lindur më ... në Gjakovë, nga i ati S. K. dhe të ëmës O. M., **I BESOHE**T në përkujdesje, ruajtje dhe edukim, babait të tij, këtu paditësit S. K..

OBLIGOHET paditësi që t'i mundësojë të paditurës, mbajtjen e kontakteve sikurse gjerë më tani, me fëmiun F. K. sipas mundësive dhe rrethanave dhe në bazë të marrëveshjes së tyre.

Shpenzimet procedurale i bartë paditësi.

A r s y e t i m

Paditësi S. K., nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar Avokatit M. B., në këtë gjykatë, ka parashtruar padi kundër të paditurës O. M., për shkak të besimit të fëmijut F. K., ka cekur palët në fillim të vitit 2015, kanë jetuar bashkërisht si bashkëshortë jashtëmartesor, pa e lidhur kurorën martesore, më datë ..., i është lindur djali F. K..

Lidhur me këtë çështje juridike, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor më 18.07.2018, në të cilën seancë kanë prezantuar i autorizuari i paditësit Avokati M. B., dhe e paditura O. M. personalisht.

I autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se ngel në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, nuk është kontestues fakti se paditësi me të paditurën kanë lidhur bashkësinë martesore në fillim të vitit 2015, se më ..., i ka lind fëmija F. dhe se pas një periudhe të shkurtër përkatësisht pas lindjes së fëmijës për shkak të mosmarrëveshjeve, e kanë shkëputur bashkësinë martesore, në mënyrë që e paditura e ka lëshuar shtëpinë dhe ka shkuar që të jetojë te motra e vetë në fshatin D., ku gjindet sod e kësaj dite. Me marrëveshje e ka lënë fëmiun te paditësi, e për të cilin përkujdeset gruaja e axhës e paditësit gjer më tani. E paditura ka deklaruar se nuk ka kushte për mbajtjen e fëmijës, kurse paditësi është me punë të përkohshme në shtetet e jashtme, posedon të gjitha kushtet materiale, dhe financiare. Duke patur parasysh mbrojtjen dhe interesin e fëmiut të mitur, për përkujdesjen, edukimin dhe zhvillimin e tij, e të cilat i ka paditësi sa i përket

kontakteve nuk ka kundërshtime ndërmjet të paditurës dhe paditësit, që fëmija ti besohet paditësit ndërsa e paditura ti ketë kontaktet me fëmijën e që gjer më tani nuk ka patur pengesë e që as në të ardhmen nuk do të ketë pengesë lidhur me kontaktet meqenëse nuk është kundërshtuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit shpenzimet procedurale i bartë paditësi dhe gjykatës i ka propozuar që pas zbatimit të provave kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar.

E paditura i vërtetoi thëniet e cekura në padi si dhe thëniet e përfaqësuesit të paditësit të cekura gjatë seancës gjatë seancës së sotme në vazhdim deklaroi se nuk e konteston kërkesëpadinë e paditësit dhe është e pajtimit që fëmiju i tyre të i besohet paditësit në përkujdesje, ruajtje dhe edukim, ngase ajo është duke jetuar te motra e saj në fshatin D., ndërsa fëmiju ka mbetur tek prindërit e paditësit. Sa i përket kontakteve ato do të zhvillohen sipas marrëveshjes së tyre dhe mundësive dhe rrethanave që do të paraqiten.

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kjo gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve, ka bërë edhe administrimin e provave si në vijim: ka bërë shikimin në ekstraktin nga Regjistri Qendror të Gjendjes Civile në Rahovec, Nr. ser. E ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, më 29.03.2018, ka bërë shikimin e raportit me shkrim të QPS-së në Rahovec Nr. – 02 - .../2018, e datës

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe bashkërisht, e duke u bazuar në dispozitën e nenin 8 të LPK-së, në bazë të bindje së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar dhe e njëjta është aprovuar**.

Me shikimin në ekstraktin nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile Nr. ser. E ..., e lëshuar pranë Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, më 29.03.2018, nga i cili vërtetohet se F. K. ka lindur me ... në Gjakovë, nga i ati S. K. dhe të ëmës O. M..

Me shikimin e raportit me shkrim të QPS-së në Rahovec Nr. – 02 - .../2018, e datës ..., në bazë të vlerësimit të rrethanave në rastin konkret, ka dhënë konstatimin dhe mendimin përfundimtarë ka dhënë pëlqimin që fëmiju i mitur F. K. të i besohet në ruajtje, edukim dhe përkujdesje të atit të tij S. K..

Duke u bazuar në lartcekurat, deklaramit të përfaqësuesit së paditësit, deklaramit të paditurës e cila nuk e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe është pajtuar që fëmija të i besohet të atit të tij, se e paditura jeton tek motra e saj në fshatin D., raportit të QPS-së, gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar.

Andaj në bazë të gjendjes faktike të lartcekurat, e duke u bazuar në nenet 139.1, 144, 145 të Ligjit për Familjen i Kosovës dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është mështetur në dispozitën e nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.137/2018, datë 18.07.2018

B. Profesional
Armond Qmega

Kryetari i trupi gjyqësor
Jonuz Bugari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë–Divizioni Civil.